



**GRUPI PARLAMENTAR**

**“MIQTË E FËMIJËVE”**

**PLANI STRATEGJIK DHE I VEPRIMIT  
2016 - 2018**

## **PËRMBAJTJA**

### **1. HYRJE**

Fq. 3

### **2. KUSH ËSHTË GRUPI PARLAMENTAR MIQTË E FËMIJËVE (GPMF) Fq. 5**

### **3. ROLI I GPMF**

Fq. 6

### **4. QËLLIMET/ORIENTIMET STRATEGJIKE TË GPMF**

Fq. 7

<b>5. BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI I GPMF</b>	<b>Fq. 7</b>
<b>6. STRUKTURA E GPMF</b>	<b>Fq. 8</b>
- Anëtarësia e GPMF	
- Komitetet e GPMF	
- Përbërja e GPMF	
<b>7. KOMUNIKIMI I GPMF</b>	<b>Fq. 9</b>
<b>8. MIRATIMI DHE AMENDIMI I KËTIJ DOKUMENTI</b>	<b>Fq. 11</b>
<b>9. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË GPMF 2016-2018</b>	<b>Fq. 12</b>

## **ANEKS 1: KALENDARI I DITËVE NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE**

## **ANEKS 2: PLANI I PUNËS/VEPRIMIT TË GPMF 2016-2018**

### **1. HYRJE**

Plani Strategjik kërkon të shërbejë si një udhërrefyes për të caktuar qëllimet, objektivat, punën dhe veprimtarinë e Grupit Parlamentar “Miq të Femijëve” (GPMF) dhe deputetët që e përbëjnë atë, përgjatë 2-3 viteve të ardhshme të funksionimit të tij. Për Shqipërinë krijimi i grupeve të tilla është një risi ndaj GPMF-ja gjykoj se ishte e domosdoshme përgatitja e një dokumenti strategjik me qëllime dhe objektiva të qartë, të cilat lehtësojnë jo vetëm punën e Grupit, por përtej tij, krijojnë një mundësi serioze për të zhvilluar një përpjekje të organizuar për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave të femijëve dhe të të rinjve në Shqipëri.

Parlamentet në çdo vend të botës demokratike luajnë një rol qëndror në përkthimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në ligje, politika dhe programe buxhetore që përmirësojnë jetën e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre, sidomos për ata që varen nga mbështetja, ndihma dhe dora e shtetit. Femijët, adoleshentët dhe të rinjtë janë një ndër grupet më të mëdha sociale në vend dhe si i tillë, ky grup ka nevojë për mbështetje, mbrojtje dhe zhvillim nga ana e institucioneve shtetërore, përfshi edhe mbështetjen dhe dedikimin që duhet të vij nga Kuvendi dhe të zgjedhurit që e përbëjnë atë.

Shqipëria ka hedhur një sërë hapash pozitive në drejtim të mbrojtjes të të drejtave të femijëve, që prej nënshkrimit dhe ratifikimit të Konventës për të Drejtat e Femijës të OKB-së. Legjislati dhe politikat për femijët dhe të rinjtë kanë avancuar, por megjithatë mbetet ende shumë për të bërë. Ky ishte edhe qëllimi kryesor pse Kuvendi i Shqipërisë, një grup deputetësh të dedikuar prej vitesh në kauzën e mbrojtjes të të drejtave të femijëve dhe të të rinjve së bashku me shoqërinë civile dhe

UNICEF Shqipëri, gjyquan se krijimi i një grupi të tillë që do të llojë dhe avokojë në emër dhe për të drejtat e fëmijëve, do të përbëntë një mundësi të mirë për të sjellë një risi në Kuvend dhe një ndryshim të prekshëm në jetën e fëmijëve dhe të të rinjve.

Nisma fillestare për krijimin e atij që fillimisht u quajt “Kaukusi i Deputetëve për të Drejtat e Fëmijëve”, u ndërmor nga deputetet znj. Vasilika Hysi dhe znj. Eglantina Gjermani dhe brenda një kohë shumë të shkurtër nisma u mbështet publikisht nga kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta dhe Kryetari i Komisionit të Ligjeve z. Fatmir Xhafaj. Si model për ngritjen e Kaukusit shërbeu Komiteti i Fëmijëve i Bundestag-ut Gjerman i themeluar nga një rezolutë e miratuar në 21 prill 1988, duke e bërë atë organin e parë parlamentar në botë të dedikuar për të përfaqësuar interesat e fëmijëve dhe një ndër më të suksesshmit në këto vite. Ky Komitet kishte për qëllim të siguronte që interesat e fëmijëve të merren parasysh në legjislacion dhe fusha të tjera të debatit parlamentar, për të shërbyer si një pikë kontakti për çështjet e fëmijëve dhe për të zhvilluar iniciativat e veta në fushën e politikave të fëmijëve.

Kaukusi Parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve ishte i pari që u krijua në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht se formalizimi i tij u bë në një periudhë më të vonshme, më datë 13 Nëntor 2013, me miratimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” përmes së cilës u vendos edhe ngritja e **Grupit Parlamentar MIQTË E FËMIJËVE në Shqipëri**, si një grup ad-hoc në Kuvendin e Shqipërisë.

Përmes kësaj Rezolutive Kuvendi i Shqipërisë u angazhua:

- Të nxisë Qeverinë që në Buxhetin vjetor të Shtetit të mundësojë buxhetin e nevojshëm për shërbimet në mbrojtje të fëmijëve, si dhe krijimin e një fondi të veçantë për fëmijët, nga i cili do të financohen të gjitha institucionet, shërbimet dhe programet për fëmijët në Shqipëri;
- Të ndërmarrë nisma dhe veprime konkrete për hartimin e legjislacionit për drejtësinë për të miturit në Shqipëri;
- Të nxisë e të mbështesë nismat ligjvënëse të deputetëve ose të Qeverisë për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kryesisht në drejtim të hartimit të politikave dhe legjislacionit përkatës për shërbimin e kujdestarisë në familje;
- Të nxisë dhe të mbështesë miratimin e Reformës së Shërbimit Social në Shqipëri;
- Të ndërmarrë veprime aktive për ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe familjes për rolin vendimtar që ajo luan në rritjen, përkujdesjen dhe respektimin e të drejtave individuale të fëmijës;
- Të vlerësojë mundësinë e krijimit të Komisionit për të Drejtat e Fëmijës, pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, mes një procesi konsultues të komisioneve parlamentare, Qeverisë, Avokatit të Popullit, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit;
- Të monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve shtetërore për zbatimin e legjislacionit për fëmijët, me fokusin e veçantë në Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës së OKB-së dhe të nxisë Qeverinë për zbatimin e Planit të Veprimit për Fëmijët;

- Të nxisë bashkëpunimin e institucioneve të pushtetit qëndror me atë vendor, për të hartuar programe, të cilat duhet të përfshijnë shërbimet shoqërore, decentralizimin e shërbimeve të tjera drejt komunitetit, policimin në komunitet dhe dhënien e ndihmës e të kujdesit për fëmijët dhe familjet në nevojë;
- Të mbështesë nismën dhe kërkesën e shoqërisë civile për të krijuar Grupin e Deputeteve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, si një grup *ad-hoc* avokatësie të parlamentarëve, që do të nxisin Kuvendin e Shqipërisë për shqyrtimin e nismave dhe veprimeve në mbështetje dhe në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- Të hartohet një plan veprimi nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me strukturat e tjera parlamentare, për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara nga kjo rezolutë.

Pas zyrtarizimit të tij, GPMF-së iu bashkuan edhe 20 deputetë të tjerë nga e gjithë Shqipëria, të cilët i kanë vendosur vetes si qëllim që të bëhen mbrojtës dhe promovues të kauzës të të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.

Plani Strategjik u përgatit nga puna dhe kontributi i jashtëzakoshëm i kryesisë së GPMF-së me mbështetjen e UNICEF dhe CRCA Shqipëri. Plani është konsultuar me tre sesione me shoqërinë civile dhe fëmijët në dy takime nga ku janë marrë edhe një sërë sugjerimesh që e përmirësuan edhe më tej përmbajtjen e tij. Si i tillë, Plani përfaqëson një dokument gjerësisht të konsultuar me deputetët që përbëjnë GPMF-në, shoqërinë civile, fëmijët dhe të gjithë ata që punojnë dhe kontribuojnë për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Sigurisht që GPMF mirëpret çdo sugjerim dhe rekomandim për përmirësimin e punës dhe veprimeve të tij.

## 2. KUSH ËSHTË GRUPI PARLAMENTAR MIQTË E FËMIJËVE (GPMF)

Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim UNICEF dhe CRCA Shqipëri, me mbështetjen e Bashkimit Europian, gjatë vitit 2013 punuan së bashku me një grup deputetësh, për të ngritur atë që në shumë parlamente në botë njihet si Kaukus (Parliamentary Caucus) Parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve. Në Shqipëri, ky grup është vendosur të quhet: Grupi Parlamentar MIQTË E FËMIJËVE (GPMF).

Ngritja e GPMF bazohet në eksperiencat më të mira të parlamenteve në Botë siç është Komiteti i Fëmijëve i Bundestag-ut Gjerman - organi i parë parlamentar në botë i dedikuar për të përfaqësuar interesat e fëmijëve dhe një ndër më të suksesshmit në këto vite, ku deputetët, i përkushtohen kauzës së mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe të adoleshentëve, duke ndërmarrë një sërë nismash, që fuqizojnë zërin e fëmijëve në organin më të lartë ligjvënës, siç është Parlamenti. Në vendet e tjera, Kaukuset kanë sjellë ndryshime madhore në jetën e fëmijëve dhe të rinjve, duke u bërë një zë i fuqishëm i mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut.

Në vijim të punës disa mujore dhe të seancës dëgjimore të mbajtur nga mbledhja e përbashkët e dy komisioneve të përhershme parlamentare, atij të Ligjeve dhe të Çështjeve Sociale, të Kuvendit të Shqipërisë në datë 13 Nëntor 2013, dhe në mënyrë të veçantë të miratimit të Rezolutës së Kuvendit “Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, u vendos ngritja e **Grupit Parlamentar MIQTË E FËMIJËVE në Shqipëri**, i cili do të funksionojë si një grup *ad-hoc* në Kuvendin e Shqipërisë.

GPMF përbëhet nga përafërsisht 23 deputetë, burra dhe gra, të përkushtuar ndër vite në avancimin e të drejtave të njeriut, të fëmijëve, të grave etj, gjë që e bën punën e Grupit, sa të larmishëm aq edhe mbështetës në drejtim të vështirimit të të drejtave të fëmijëve nga këndvështrime dhe eksperiencia të ndryshme profesionale, duke propozuar edhe zgjidhje shumëdisiplinare të ligjvënësve.

GPMF ka si synim kryesor angazhimin e deputetëve që kanë treguar ndjeshmëri dhe avokojnë për të drejtat e fëmijëve me qëllim që të krijohet një klimë mbështetëse për çështjen e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë, marrjen e nismave ligjore, hartimin e politikave efektive për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe për të garantuar që institucionet shtetërore që punojnë për fëmijët do të kenë mbështetje në punën e tyre nga Kuvendi dhe do të japin llogari përpara tij për arritjet dhe sfidat.

### **3. ROLI I GPMF**

Roli i GPMF është të propozojë e të mbështesë nisma të reja legislative që mbrojnë dhe promovojnë të Drejtat e femijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri; të promovojë instrumenta që kanë të bëjnë me eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve, përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe shtimit të gamës së shërbimeve të reja për fëmijët anëmbanë Shqipërisë.

Në kuadër të reformave të rëndësishme që po kryhen për forcimin e shtetit të së drejtës, reformën në drejtësi dhe respektimin e të drejtave të njeriut, GPMF është një mekanizëm i duhur i mbështetjes, konsultimit dhe propozimit të nismave legislative që nxisin mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Roli i GPMF, është i gjerë dhe në parim duhet të udhëheqë si procesin e përgatitjes së ligjeve të reja, ashtu edhe të ushtrimit të kontrollit parlamentar për punën që bëjnë institucionet për të zbatuar ligjet dhe mbrojtur fëmijët.

Roli i tij shtrihet në këto aspekte:

- Ndërmarrja e nismave legislative të përbashkëta me shoqërinë civile, por edhe të deputetëve të veçantë, për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ndërgjegjësimin e publikut mbi situatën e të drejtave të fëmijëve dhe rëndësinë e respektimit të tyre;
- Organizimin e seancave dëgjimore me përfaqësues të Qeverisë dhe OJF-ve për të mbledhur informacion mbi situatën e fëmijëve;
- Promovimin e instrumentave të reja ligjore ndërkombëtarë të të drejtave të fëmijëve;
- Monitorimi i progresit të Shqipërisë në lidhje me zbatimin e instrumentave ndërkombëtarë për të drejtat e fëmijës dhe në mënyrë të veçantë të *Aquis* të Bashkimit Europian;
- Sjellja në vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë dhe deputetëve të saj të raporteve dhe të dhënave që flasim për ndikimin dhe pasojat e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit kundër fëmijëve;

- Alokimi i burimeve financiare të mjaftueshme për promovimin dhe mbështetjen e shërbimeve për fëmijët, në nivel vendor dhe kombëtar.
- Të zhvillojnë seanca pyetje–përgjigje për çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien e fëmijëve, seancave dëgjimore me grupet e interesit dhe përfaqësues të institucioneve që kanë përgjegjësi për fëmijët, si dhe të zhvillojnë interpelanca për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Anëtarët e GPMF janë zëri i ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe respektimin e fëmijëve dhe të të drejtave të tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

#### **4. QËLLIMET STRATEGJIKE TË GPMF**

Qëllimi kryesor i GPMF është zbatimi i plotë i Rezolutës “Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Nëntor 2013.

Grupi parlamentar “Miq të Fëmijëve” synon të jetë proaktiv në punën për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ndër të tjera, orientimet strategjike të GPMF, përfshijnë:

- Mbrojtje dhe fuqizim të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri;
- Angazhim pro-aktiv për ta vendosur interesin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve, në qendër të Ligjeve, politikave dhe programeve kombëtare në Shqipëri;
- Nisma në nivel vendor e kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, për avancimin e të drejtave të fëmijëve.

#### **5. BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI I GPMF**

GPMF është e hapur për bashkëpunim, mbështetje dhe partneritet me organizata të shoqërisë civile në nivel lokal dhe qendror, institucione publike, institucione të pavaruara, botën akademike, biznesin, median, grupet e fëmijëve dhe të rinjve dhe çdo të interesuar që do të ndihmojë GPMF në përmbushjen e objektivave të tij.

CRCA Shqipëri dhe UNICEF Shqipëri do të mbështesë GPMF duke i vënë në dispozicion burimet e saj njerëzore, ekspertizën dhe sipas mundësive edhe burime financiare.

Në kuadër të miratimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë në datë 26 Nëntor 2013 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”, GPMF do të ftojë dhe nxisë bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjithë partnerët e shoqërisë civile, organizatat dhe grupet e fëmijëve, Ministrinë dhe institucionet publike, Universitetet dhe bizneset, për të ndërtuar një Plan Veprimi të përbashkët për arritjen e të gjitha detyrimeve që burojnë nga Rezoluta.

Bashkëpunimi i Kuvendit të Shqipërisë dhe në mënyrë të posaçme i GPMF me shoqërinë civile është i rëndësishëm në një sërë aspektesh. *Së pari*, Kuvendi përfaqëson qytetarët dhe po ashtu, shoqëria civile përfaqëson interesat e tyre. *Së dyti*, bashkëpunimi midis të zgjedhurve dhe shoqërisë civile rrit premisat e sjelljes së zërit të qytetarëve më afër parlamentarëve, si një mënyrë për të

adresuar problemet e tyre; *Së treti*, ndikon në planifikimin e nismave të përbashkëta dhe rritjen e llogaridhënies së qeverisë dhe institucioneve shtetërore përkundrejt të zgjedhurve dhe qytetarëve.

Nga ana tjetër GPMF do të bashkëpunojë ngushtësisht me institucionet publike, botën akademike dhe biznesin, për shkak të rolit, misionit dhe përgjegjësive që secili prej tyre luan në shoqëri.

GPMF për të realizuar objektivin madhor të saj, që është mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, do të bashkëpunojë ngushtësisht me shoqërinë civile dhe grupet e fëmijëve dhe të rinjve, nëpërmjet ngritjes së një plani të përbashkët pune, i cili do të zbatohet përgjatë viteve 2016-2018.

## **6. STRUKTURA E GPMF**

Struktura e GPMF është e përbërë nga Kryetari, Nën/kryetaret, Anëtarët dhe Komitetet. Kryetari i Parlamentit të Shqipërisë është edhe Kryetari i GPMF duke pasur një rol honorifik.

GPMF koordinohet nga 3 deputete të Kuvendit që janë njëkohësisht edhe nën-kryetare të tij, specifikisht kryetaret e Nën/komisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut; Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Nën/komisioni për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje.

Drejtimi i Koordinimit rregullohet me rotacion mes tre nën-kryetareve me konsensus mes tyre në baza 4/6 mujore. GPMF aktualisht përbëhet nga 23 parlamentarë: 19 anëtarë si edhe kryetari e 3 nën kryetaret, por gjithsesi ai është i hapur për të zgjeruar anëtarësinë e tij. Brenda GPMF do të krijohen komitete të vogla, të deputetëve anëtarë, të specializuara për të ndjekur çështje specifike.

### **Anëtarësia e GPMF**

Pjesmarrja e deputetëve nga Kuvendi i Shqipërisë është e hapur dhe pjesmarrja e tyre në **GPMF** përfshin çdo grup parlamentar të partive politike që kanë deputetë në Kuvend. Kjo në vetëvetë është një arritje e Kuvendit, grupeve parlamentare dhe vetë deputetëve, pasi tregon që dedikimi i tyre për avancimin e të drejtave të fëmijëve, është një kauzë që i përfshin të gjithë.

### **Komitetet e GPMF**

Një ndër idetë e shprehura nga GPMF ka qenë krijimi i komiteteve të vogla të deputetëve brenda **GPMF** për të ndjekur çështje me interes për deputetët dhe që njëkohësisht do të mundësonin informimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile, institucionet publike etj. Një komitet mund të përbëhet nga 2-3 deputetë që vijnë nga komisione të ndryshme parlamentare. Disa nga këto komitete mund të jenë:

- Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna;
- Komiteti për të Miturit në Konflikt me Ligjin;
- Komiteti për Fëmijët në Institucione Publike;
- Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve;
- Komiteti për Marrëdhëniet me OSHC-të;

- Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve.

## **Përbërja e GPMF**

**Kryetar : Z. Ilir Meta**, Kryetar i Kuvendit

**Nën-kryetare**: **Znj. Albana Vokshi**, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë; **Znj. Olta Xhaçka**, Kryetare e Nën-Komisionit Parlamentar për të Miturit, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje; **Znj. Vasilika Hysi**, Kryetare e Nën-Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut.

## **Anëtarë**

- |                           |                           |
|---------------------------|---------------------------|
| 1. Znj. Albina Deda       | 11. Znj. Kejdi Mehmetaj   |
| 2. Z. Arben Çuko          | 12. Znj. Klodiana Spahiu  |
| 3. Znj. Arta Dade         | 13. Znj. Liljana Elmazi   |
| 4. Znj. Blerina Gjylameti | 14. Z. Omer Mamo          |
| 5. Z. Eduart Selami       | 15. Znj. Majlinda Bregu   |
| 6. Znj. Evis Kushi        | 16. Znj. Mesila Doda      |
| 7. Z. Ervin Koçi          | 17. Znj. Mimoza Hafizi    |
| 8. Znj. Esmeralda Shkaj   | 18. Znj. Monika Kryemadhi |
| 9. Znj. Jorida Tabaku     | 19. Z. Xhemal Qefalia     |
| 10. Z. Kastriot Islami    |                           |

## **7. KOMUNIKIMI I GPMF**

GPMF do të zhvillojë komunikimin e saj me publikun e gjerë, fëmijët, të rinjtë, deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, me grupe të tjera të ngjashme në rajon, me institucionet, me median, etj., përmes disa mënyrave si: a) një Rubrike të posaçme për GPMF në faqen e internetit të Kuvendit; b) një Fletpalosje të GPMF-së; c) një Udhëzuesi se ”Çfarë parlamentarët mund të bëjnë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna”; d) prezantimeve mediatike, etj.

### **a) Rubrika e GPMF-së në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë**

Në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë do të hapet një Rubrikë e posaçme e titulluar “Grupi i Deputetëve Miqtë e Fëmijëve”. Kjo rubrikë do të ketë si qëllim të pasyrojë aktivitetet e Grupit, të njohë publikun e gjerë, fëmijët dhe gjithë të interesuarit me punën dhe rolin e tij, me nismat legjislative të ndërmarra në mbështetje të fëmijëve, me dokumentat e grupit, anëtarët e tij, etj. Rubrika do të ketë edhe një sesion për të kontaktuar me anëtarët e grupit. Pasurimi i vazhdueshëm i rubrikës me informacion në gjuhën shqip dhe anglisht, rreth legjislacionit shqiptar për fëmijët, insitucionet që punojnë për ta si edhe studimeve më të fundit për situatën e fëmijëve në vend, do t’ju vijë në ndihmë jo vetëm shqipfolësve por edhe të interesuarve të huaj e ndërkombëtarë.



#### **b) Fletpalosja e GPMF-së**

Përgatitja e Fletpalosjes së GPMF-së do të shërbejë për të njohur publikun e gjerë me GPMF-në, përbërjen e tij, rolin, misionin, orientimet strategjike dhe objektivat e tij. Kjo mënyrë komunikimi do të synojë të promovojë grupin dhe ta bëjë atë të njohur gjerësisht, përmes vendosjes së fletpalosjes online në rubrikën e internetit por edhe përmes shpërndarjes së versionit në hard-copy në të gjitha aktivitetet që GPMF do të organizojë.

#### **c) Udhëzuesi "Çfarë mund të bëjnë Parlamentarët për të mbrojtur fëmijët nga dhuna"**

Përgatitja e këtij Udhëzuesi do të jetë një përpjekje e grupit dhe Parlamentit shqiptar për zhvillimin dhe dokumentimin e praktikave, mekanizmave dhe burimeve të përdorura prej tij për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Ky udhëzues do të shërbejë si një model pozitiv dhe si një burim informacioni për deputetët e tjerë, jo vetëm të Kuvendit të Shqipërisë por edhe të rajonit e më gjerë. Dokumentimi i praktikave të përdorura nga GPMF, në këtë udhëzues, për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe fenomeneve të tjera, do të bëjë të mundur shpërndarjen e modelit të punës së GPMF-së në vendet e tjera të rajonit të cilat mund të nxiten për të ngritur grupe të ngjashme.

#### **d) Prezantime mediatike**

Përdorimi i medias së shkruar e asaj vizive do të jetë një ndër mënyrat e komunikimit të GPMF-së me publikun e gjerë. Përmes daljeve mediatike të anëtarëve të GPMF-së, synohet që ky grup të shndërrohet në një pikë referimi për gazetarët, vetë fëmijët e të rinjtë dhe për publikun e gjerë për iniciativat ligjore të ndërmarra për fëmijët dhe të rinjtë. Debatet, prezantimet në emisione televizive e radio-fonike do të shërbejnë si një mundësi e mirë për të bërë publike iniciativat e grupit por edhe për të përcjellë mesazhe në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Deklaratat e njoftimet për shtyp në rast eventesh apo shkeljesh të të drejtave të fëmijëve do të përdoren si mënyrë reagimi në lidhje me çdo rast që mund të jetë shkelje e të drejtave të fëmijëve apo për çështje që kanë të bëjnë direkt apo edhe indirekt me punën e grupit. Konferencat për shtyp do të synojnë të sjellin në vëmendje të publikut çështje të rëndësishme e kyçe të fëmijëve e të rinjve apo të iniciativave të suksesshme të GPMF. Çdo produkt komunikimi që GPMF prodhon, si raporte, publikime, etj., do të dërgohet përmes formave elektronike apo dhe të shtypur përfaqësuesve të medias. Në rastet e ditëve ndërkombëtare të lidhura me të drejtat e fëmijëve, GPMF do të marrë përsipër të organizojë evente e takime mediatike për të adresuar mediatikisht problemet e fëmijëve/të rinjve.

### **8. MIRATIMI DHE AMENDIMI I KËTIJ DOKUMENTI**

Ky dokument do të miratohet në mbledhjen e parë të anëtarësisë së GPMF me shumicë votash. Amendimet e dokumentit mund të bëhen në çdo kohë me propozimin e një grupi anëtarësh. Ai

do të rishikohet në mënyrë periodike në dakortësi me GPMF. Propozimet për amendime duhet tu vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve të GPMF 2 javë përpara mbledhjes së radhës dhe do të miratohen me shumicë votash në mbledhjen e radhës.

## 9. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË GPMF 2016-2018

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
<p><b>Objektiv Strategjik 1:</b></p> <p><b>GMPF është forcuar për të ushtruar funksionet dhe rolin e tij brenda Kuvendit të Shqipërisë.</b></p>	<p>Finalizimi i Planit Strategjik të GPMF dhe i Rregullores së brendshme të GPMF</p>	<p>1.1 Mbledhje e anëtarësisë së GPMF për finalizimin dhe miratimin e Planit Strategjik / Planit të Veprimit dhe Rregullores se Brendshme</p> <p>1.2 Plani Strategjik i GPMF vendoset online në faqen e Kuvendit</p> <p>1.3 Përgatitja e një Liste të deputetëve dhe e kontakteve të tyre për të patur vijueshmëri në komunikimin e punës së GPMF dhe nismave të përbashkëta</p> <p>1.4 Ndarja e GPMF në komitete pune dhe funksionimi i tyre në bazë të çështjeve respektive</p> <p>1.5 Hartimi i dokumentave / memo-ve dhe organizimi i seancave orientuese dhe informuese për anëtarët e</p>	<p>Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit të GPMF miratohet dhe zbatohet nga anëtarët;</p> <p>140 deputetë të Kuvendit, institucionet qeveritare, të pavarura dhe jo-qeveritare njihen me Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimit të GPMF</p> <p>GPMF funksionon në bazë të rregullores dhe planit të veprimit;</p> <p>Ndërgjegjësimi/informimi dhe sjellja në vëmendjen e anëtarëve të GPMF të çështjeve/ situatës/ problematikave të fëmijëve/ të rinjve;</p> <p>Ngritja dhe funksionimi i sesionit të posaçëm të GPMF në faqen web të Kuvendit</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë dhe funksionalitetin e</p>	<p>Raporte pune</p> <p>Raportime ne media</p> <p>Faqja web e Kuvendit</p> <p>Minutat e takimeve te GPMF</p>

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
	<p>GPMF është informuar mbi çështjet e fëmijëve/të rinjve në Shqipëri në bashkëpunim me OSHC-të</p> <p>Ndërgjegjësimi i publikut mbi punën e GPMF dhe mbi çështjet e fëmijëve/të rinjve</p>	<p>GPMF mbi çështjet e fëmijëve/të rinjve (takime me femijë dhe të rinj);</p> <p>1.6 Krijimi i një database me studime/raporte dhe statistika të realizuara nga OSHC-të dhe ndarja e tyre me GPMF-në</p> <p>1.7 Informim dhe ndërgjegjësim i GPMF nga OSHC-të nëpërmjet tryezave, konsultimeve të përbashkëta mbi situatën/çështjet e fëmijëve/të rinjve / Liste të plotë të OSHC-ve, dhe shërbimeve<sup>1</sup> e programeve të ofruara prej tyre.</p> <p>1.8 Krijimi dhe plotësimi i rubrikave të sesionit të posaçëm në ëeb e parlamentit me info, axhendë, aktivitete të përditësuara të GPMF dhe nismave për fëmijët/të rinjtë;</p>	<p>GPMF mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve / të rinjve</p> <p>Të paktën 2 nisma parlamentare në konsultim me fëmijët dhe të rinjve janë mbështetur nga GPMF</p>	
<b>Objektiv Strategjik 2:</b>		Akt. 2.1 Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të	Raport i përmbledhur Vjetor i Nismave Legjislative dhe	Raporte pune

<sup>1</sup> Harta e Shërbimeve - UNICEF

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
<p><b>GPMG ndërmerr dhe mbështet nisma ligjvënëse për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në Shqipëri.</b></p> <p>(Drejtësia për të miturit, shërbimi i kujdestarisë në familje, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi e trafikimi dhe miratimin e Reformës së Shërbimit Social në Shqipëri {Zotimi 2, 3, 4 i Rezolutës})</p>	<p># OSHC të konsultuara me GPMF për ndryshimet /nismat ligjore</p> <p># niveli i komunikimit dhe bashkëpunimit midis GPMF dhe OSHC-ve</p> <p># nismave legjislative për fëmijët / të rinjtë që Kuvendi merr në konsideratë për t'i shqyrtuar dhe miratuar</p> <p>% Rritje buxheti për shërbimet në mbrojtje të fëmijëve, bazuar në rekomandimet e Rezolutës;</p>	<p>Përvitshëm të zbatimit të Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri</p> <p>Akt. 2.2 Lista e nismave legjislative që Kuvendi duhet ti marr në konsideratë për t'i shqyrtuar dhe miratuar</p> <p>Akt. 2.3 Tryeza Konsultimi të GPMF dhe Komisionit Parlamentar të Financave, me OSHC-të dhe ASHMDF për të marrë mendimin e tyre lidhur me buxhetin e shtetit</p> <p>Akt. 2.4 Raport i përmbledhur i Nismave Legjislative për të drejtat e fëmijëve/të rinjve të ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë</p> <p>Akt. 2. 5 Tryeza të përbashkëta konsultuese të GPMF me OSHC-të mbi ndryshimet /nismat ligjore.</p>	<p>veprimtarive të kontrollit parlamentar për të drejtat e fëmijëve/të rinjve të ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë hartohet dhe publikohet në ëeb-faqe</p> <p>Përmirësime të bëra në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përmes nismave ligjore dhe kontrollit parlamentar (seancave dëgjimore, interperlancave, dëgjësave publike etj)</p> <p>Buxheti i shtetit është rritur për të mbështetur nisma dhe shërbime të reja në nivel kombëtar fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri.</p> <p>2 seanca dëgjimore në vit organizohen në Kuvend me OSHC-të, fëmijët dhe partnerët në lidhje me situatën e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve ne vend;</p>	<p>Raportime në media</p> <p>Minuta takimesh te GPMF ose të Komisioneve të Kuvendit</p>
<p><b>Objektiv Strategjik 3:</b></p>	<p># i takimeve / raportimeve të</p>	<p>Akt 3.1 Takime individuale / në komisione parlamentare të</p>	<p>ASHMDF angazhohet në zbatimin e plotë të Planit të Veprimit për</p>	<p>Raporte pune</p>

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
<p><b>GPMF siguron mbikëqyrjen / kontrollin parlamentar efektiv të Qeverisë, të institucioneve shtetërore dhe institucioneve të pavarura mbi çështjet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.</b></p> <p><i>(Zotimi nr. 1, 6, 7, 8 i Rezolutës)</i></p>	<p>institucioneve shtetërore përpara komisioneve të kuvendit</p> <p># Raporte të veçanta të Institucioneve të pavarura lidhur me shkeljet e të drejtave të fëmijëve/të rinjve dhe masat e marra prej tyre përgatiten dhe ndahen me GPMF</p>	<p>anëtarëve të GPMF me insitucionet kyçe publike dhe të pavarura</p> <p>Akt 3.2 Tryezë Diskutimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Fëmijët mes GPMF dhe ASHMDF</p> <p>Akt 3.3 Dëgjesë publike në lidhje me Reformën Territoriale (Nga niveli qendror në atë lokal)</p> <p>Akt 3.4 Vizita në terren deputetët e GPMF në një institucion arsimor, shëndetësor, qendër sociale, etj.</p> <p>Akt 3.5 GPMF informohet nga Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për të qenë në kontakt me zhvillimet për të drejtat e fëmijëve dhe të mbikqyrë punën e tij</p>	<p>Fëmijët dhe përmirësimin e situatës së tyre</p> <p>Shërbimet në mbrojtje të fëmijëve buxhetohen në buxhetin e shtetit dhe ministritë përgjegjëse</p> <p>Zbatimi i Reformës Territoriale merr në konsideratë interesin e fëmijës dhe nxit qytete / shërbime miqësore për fëmijët</p> <p>Këshilli Kombëtar i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve informon GPMF periodikisht për situatën e të të drejtave të fëmijëve / të rinjve</p> <p>Përmirësimi i punës së institucioneve të pavarura lidhur me masat e marra prej tyre për shkeljet e të drejtave të fëmijëve/të rinjve</p> <p>Komisioneri për të Drejtat e Fëmijës emërohet, pranë Zyrës së Avokatit të Popullit dhe bëhet funksional</p>	<p>Raportime ne media</p> <p>Faqja e web e Kuvendit</p> <p>Minuta takimesh te GPMF dhe / ose të Kuvendit</p>

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
<p><b>Objektiv Strategjik 4:</b></p> <p><b>GPMF në bashkëpunim edhe me OSHC-të, nxit dhe mbështet pjesmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendim-marrjen e Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë më të drejtat e tyre.</b></p> <p><i>(zotimi nr. 5 i Rezolutës)</i></p>	<p># e fëmijëve dhe të rinjve pjesë e proceseve konsultuese të GPMF</p> <p># i konsultimeve dhe takimeve të zhvilluara ndërmjet deputetëve, komisioneve parlamentare dhe fëmijëve / të rinjve;</p>	<p>Akt 4.1 Dëgjese publike me fëmijë dhe të rinj në lidhje me zbatimin e programeve për fëmijët/të rinjtë (mbrojtje sociale, shëndetësi, arsim, transport, planifikimi urban, etj.)</p> <p>Akt 4.2 Deputetët dhurojnë për fëmijët në nevojë për festat e fund-vitit.</p> <p>Akt 4.3 Organizimi i aktiviteteve filantropike në mbështetje të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë</p> <p>Akt 4.4 Evente të përbashkëta GPMF-OSHC në kuadër të ditëve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut/fëmijëve (ditë tematike, ekspozita, takime, etj)</p> <p>Akt 4.5 Fëmijët i dërgojnë letra deputetëve në faqen web/kutinë postare GPMF / Fëmijët / të rinjtë takohen me deputetët.</p>	<p>Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në kuvend për t'u dëgjuar nëpërmjet seancave dëgjimore dhe aktiviteteve konsultuese</p> <p>Grupi "Fëmijët dhe të Rinjtë në Parlament" mbështetet dhe konsultohet me GPMF-në</p> <p>Deputetë/Institucionet/publiku ndërjegjësohen lidhur me pjesmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje</p> <p>Informimi i vazhdueshëm i fëmijëve dhe të rinjve mbi punën e GPMF dhe Kuvendit lidhur me fëmijët</p> <p>Raport Vjetor mbi zbatimin e Rezolutës</p>	<p>Raporte pune</p> <p>Raportime ne media</p> <p>Faqja e web e Kuvendit</p> <p>Minuta takimesh te GPMF</p>

Objektivat strategjike	Indikatorët	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme per vitin 2016-2018	Mjetet e verifikimit
		Akt 4.7 Raport vlerësues dhe monitorues për punën e Kuvendit dhe zbatimin e Rezolutës (p.sh. përmes metodës VKQ)		

## ANEKS 1: KALENDARI I DITËVE NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

### Mars

1 Mars – Dita e Diskriminimit 0

21 Mars – Dita Ndërkombëtare për Eleminimin e Diskriminimit Racial

21 Mars – Dita Botërore e Sindromës Down

### Prill

2 Prill – Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin

7 Prill – Dita Botërore e Shëndetit

### Maj

15 Maj – Dita Ndërkombëtare e Familjes

### Qershor



1 Qershor - Dita Botërore e Prindërve

12 Qershor – Dita Botërore kundër Punës së Fëmijëve

### **Korrik**

15 Korrik - Dita Botërore e Aftësive të Rinjve

30 Korrik - Dita Botërore kundër Trafikimit të Personave

### **Gusht**

12 Gusht - Dita Ndërkombëtare e Rinjve

### **Tetor**

2 Tetor – Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës

11 Tetor – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza

### **Nëntor**

20 Nëntor – Dita Universale e Fëmijëve

### **Dhjetor**

3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e PAK

10 Dhjetor – Dita e Drejtave të Njeriut

20 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor

## **ANEKS 2: PLANI I PUNËS/VEPRIMIT TË GPMF 2016-2018**

	Masat Konkrete / Aktivitetet	Personi Përgjegës	Afatet kohore						Komente/Progresi i Arritur/Problematika	
			Korrik	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2017	2018	
<b>Objektiv Strategjik 1:</b>	<b>GMF është forcuar për të ushtruar funksionet dhe rolin e tij brenda Kuvendit të Shqipërisë.</b>		<b>2016</b>							
			<b>Korrik</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	

1.1	Mbledhje e anëtarësisë së GPMF për finalizimin dhe miratimin e Planit Strategjik / Planit të Veprimit dhe Rregullores së Brendshme									Përfunduar në Prill 2016
1.2	Plani Strategjik i GPMF vendoset online në faqen e Kuvendit									Do të publikohet në Korrik 2016
1.3	Përgatitja e një Liste të deputetëve dhe e kontakteve të tyre për të patur vijueshmëri në komunikimin e punës së GPMF dhe nismave të përbashkëta									E përfunduar
1.4	Ndarja e GPMF në komitete pune dhe funksionimi i tyre në bazë të çështjeve respektive									Drafti është përgatitur, priten inpute nga GPMF
1.5	Hartimi i dokumentave / memo-ve dhe organizimi i seancave orientuese dhe informuese për anëtarët e GPMF mbi çështjet e fëmijëve/të rinjve (takime me femijë dhe të rinj);			Punë përgatitore						Déance dëgjimore në lidhje me DHNF e organizuar në 2016

1.6	Krijimi i një database me studime/raporte dhe statistika të realizuara nga OSHC-të dhe ndarja e tyre me GPMF-në									CRCA mbledh studimet/raportet kryesore dhe ja kalon pikes fokale për ti hedhur online.
1.7	Informim dhe ndërgjegjësim i GPMF nga OSHC-të nëpërmjet tryezave, konsultimeve të përbashkëta mbi situatën/çështjet e fëmijëve/të rinjve / Liste të plotë të OSHC-ve, dhe shërbimeve <sup>2</sup> e programeve të ofruara prej tyre									CRCA do të përgatisë listen e plotë të OSHC që punojnë me fëmijët, me emrin e organiztaës, personin e kontaktit dhe të dhënat e plota.
1.8	Krijimi dhe plotësimi i rubrikave të sesionit të posaçëm në ëeb e parlamentit me info, axhendë, aktivitete të									Seksioni është krijuar: për tu përditësuar periodikisht
<b>Objektiv Strategjik 2:</b>	<b>GPMG ndërmerr dhe mbështet nisma ligjvënëse për përmirësimin e</b>									

<sup>2</sup> Harta e Shërbimeve - UNICEF

	<b>kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në Shqipëri.</b>									
2.1	Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Përvitshëm të zbatimit të Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri									Raporti I draftuar. Për tu finalizuar.
2.2	Lista e nismave legislative që Kuvendi duhet ti marr në konsideratë për t'i shqyrtuar dhe miratuar									Lista e përgatitur nga CRCA
2.3	Tryeza Konsultimi të GPMF dhe Komisionit Parlamentar të Financave, me OSHC-të dhe ASHMDF për të marrë mendimin e tyre lidhur me buxhetin e shtetit									Muaj tentative Nëntor/Dhjetor
2.4	Raport i përmbledhur i Nismave Legislative për të drejtat e fëmijëve/të rinjve të									

	ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë									
2.5	Tryeza të përbashkëta konsultuese të GPMF me OSHC-të mbi ndryshimet /nismat ligjore.									Në vijimësi
<b>Objektiv Strategjik 3:</b>	<b>GPMF siguron mbikëqyrjen / kontrollin parlamentar efektiv të Qeverisë, të institucioneve shtetërore dhe institucioneve të pavarura mbi çështjet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.</b>									
3.1	Takime individuale / në komisione parlamentare të anëtarëve të GPMF me insitucionet kyçe publike dhe të pavarura									
3.2	Tryezë Diskutimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Fëmijët									

3.3	Dëgjesë publike në lidhje me Reformën Territoriale (Nga niveli									
3.4	Vizita në terren deputetët e GPMF në një institucion arsimor, shëndetësor, gjendësor									
3.5	GPMF informohet nga Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për të qenë në kontakt me zhvillimet për të drejtat									Për tu ndjekur në 2017
<b>Objektiv Strategjik 4:</b>	<b>GPMF në bashkëpunim edhe me OSHC-të, nxit dhe mbështet pjesmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendim-marrjen e Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë më të drejtat e tyre.</b>									
4.1	Dëgjesë publike me fëmijë dhe të rinj në lidhje me zbatimin e programeve për fëmijët/të rinjtë (mbrojtje sociale, shëndetësi, arsim,				Preparatory work					Parashikuar për tu zhvilluar në Nëntor 2016 duke përfshirë fëmijë, UNICEF dhe GPMF

	transport, planifikimi urban, etj.									
4.2	Deputetët dhurojnë për femijët në nevojë për festat e fund-vitit.									
4.3	Organizimi i aktiviteteve filantropike në mbështetje të <del>shërbimeve për femijët</del>									
4.4	Evente të përbashkëta GPMF-OSHC në kuadër të ditëve ndërkombëtare të të drejtave të									
4.5	Fëmijët i dërgojnë letra deputetëve në faqen web/kutinë postare GPMF / Fëmijët / të rinjtë takohen me									
4.6	Raport vlerësues dhe monitorues për punën e Kuvendit dhe zbatimin e Rezolutës (p.sh. përmes metodës VKQ)									